VENDIM
Nr. 83, datë 30.3.2021

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "REI – ENERGJI" SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC "LINGJACA 1", ME KAPACITET TË INSTALUAR 1897 *kw*, HEC "LINGJACA 2", ME KAPACITET TË INSTALUAR 300 *kw*, ME KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR 2197 *kw*

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa "a", nenit 5, pika 1, germa "a", nenit 13, të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar, si dhe nenit 15, të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.3.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 39/2 prot., datë 24.3.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi licencimin e shoqërisë "Rei – Energji" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Lingjanca 1", me kapacitet të instaluar 1897 *kw* dhe "Lingjanca 2", me kapacitet të instaluar 300 kW, me kapacitet total të instaluar 2197 *kw*,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 56, datë 22.2.2021, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "REI – ENERGJI" sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Lingjanca 1", me kapacitet te instaluar 1897 *kw*, HEC "Lingjanca 2", me kapacitet të instaluar 300 *kw*, me kapacitet total të instaluar 2197 *kw*, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit të Lingjances, Bashkia Librazhd, qarku Elbasan, për një afat 25 vjet e 10 muaj.

- Në vijim të vendimmarrjes së ERE-s, me shkresën nr. 6/8 prot., datë 22.2.2021, është bërë publikimi në medien e shkruar në lidhje me fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike për HEC-et: "Lingjanca 1" dhe HEC "Lingjanca 2" dhe në përfundim të afatit të njoftimit, nuk rezulton të ketë pasur vërejtje apo ankesa nga palë të interesuara.

- ERE, me shkresën nr. 424 prot., datë 5.3.2021, ka njoftuar shoqërinë "Rei – Energji" sh.p.k., lidhur me vendimmarrjen e Bordit, për fillimin e procedurave për licencimin e saj në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, duke i bërë me dije nevojën për të depozituar dokumentacionin e konstatuar si të munguar apo plotësuar pjesërisht sipas vendimit nr. 56/2021.

- Shoqëria "Rei – Energji" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 424/1 prot., datë 16.3.2021, ka përcjellë dokumentacionin e munguar.

- Nga analiza e dokumentacionit në fazën përfundimtare të licencimit në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, për shoqërinë "Rei – Energji" sh.p.k., rezulton se subjekti plotëson tërësisht kërkesat e rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, germat "a", "b" dhe "c", plotësuar.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germat "a", "b", "c", "d", "e", "f", "g". Plotësuar;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germat "a", "b", "c", "d". Plotësuar;

- Dokumentacioni teknik për HEC-in, neni 9, pikat 41.1, 4.1.2, 4.1.3, germat "a", "b", "c", "d", dhe pika 4.1.4, germat "a", "b", "c", "d", "e", "f". Plotësuar.

- Leje nga institucione të tjera, neni 9, pika 4.1.5, germat "a", "b", "c". Plotësuar.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t'u pajisur me licencë prodhimi nga ERE, në zbatim të aneksit A, të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike".

- Shoqëria ka saktësuar edhe emërtesën e HEC-eve duke konfirmuar se emërtesa e saktë është: "Lingjanca 1 dhe Lingjanca 2" dhe përdorimi në disa nene të kontratave me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) si Lingjaca është gabim ortografik.

- Në përfundim të afatit të kontratës së qirasë me Bashkinë e Përrenjasit (data e përfundimit: 13.05.2027), shoqëria duhet ta depozitojë atë me afate të rinovuara, jo më vonë se një muaj pas nënshkrimit të rinovimit.

- Kontrata nr. 57 REP., nr. 16 KOL., datë 23.1.2012, "Kontratë e formës BOT ndërtim-operim-transferim, për ndërtimin e hidrocentralit 'Lingjanca'"; ka një afat 35-vjeçar, por, nga ana tjetër, shpjegojmë se ERE, në zbatim të nenit 38, të ligjit "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, dhe nenit 5, të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", e ndryshuar, nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të madh se 30 vjet.

- Në rastin konkret konstatohet se kontrata e koncesionit sipërcituar është nënshkruar në datën 23.1.2012 (data efektive) dhe si e tillë shoqëria ka humbur 9 vite nga periudha e koncesionit.

Në nenin 5, "Kohëzgjatja e vlefshmërisë së licencës", pika 2, të rregullores së licencimit përcaktohet se: për aplikimet në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, të cilat paraqiten në ERE më vonë se data efektive e kontratës/autorizimit, llogaritja e afatit së licencimit, bëhet për periudhën e mbetur. Ky rregull vlen edhe për rastet e modifikimit të licencave".

Sa më sipër, nisur nga llogaritja e afateve të humbura të koncesionit, kjo shoqëri duhet të licencohet për një periudhë 25 vjet e 10 muaj.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Rei – Energji" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Lingjanca 1", me kapacitet te instaluar 1897 *kw*, HEC "Lingjanca 2" me kapacitet të instaluar 300 *kw*, me kapacitet total te instaluar 2197 *kw*, për një afat 25 vjet e 10 muaj.

2. Shoqëria "Rei – Energji" sh.p.k., në përfundim të afatit të kontratës së qirasë me Bashkinë Përrenjas (data e përfundimit 13.5.2027), duhet ta depozitojë atë me afate të rinovuara, jo më vonë se një muaj pas nënshkrimit të rinovimit.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti